

## GJOVALIN SHKURTAJ

## RRETH DISA VEÇORIVE TË GJUHËS SË KËNGËVE POPULLORE

Raporti në mes të gjuhës së folur dhe gjuhës së këngës, me gjithë rëndësinë dhe interesin që paraqet, në gjuhën tonë nuk është bërë objekt studimesh të veçanta. Për këngët e Veriut problemin e kanë cekur E. Çabej në studimin «Për gjenezën e literaturës shqipe», 1939, dhe, sidomos, M. Lamerci në studimin e gjatë «Die Volksepik der Albaner», 1958. Disa vlerësime të përgjithshme, pa i konkretizuar me shembuj, jep edhe A. Desnickaja në «Albanskij jazyk i jego dialekti» 1968. Për këngët e Jugut një përpjekje të parë ka bërë V. Fidler në artikullin «Disa çështje të metrikës së këngëve popullore çame»<sup>1</sup>, në të cilin ka vënë në dukje disa interpolacione që ngjasin në gjuhën e këngëve gjatë interpretimit.

Përbërja fonetike dhe morfologjike e gjuhës së këngëve ka specifikën e vet, e cila shpeshherë përcaktohet nga struktura ritmiko-melodike e këngës ose e vjershës epike, prandaj del e nevojshme të vëzhgohet kjo specifikë, të njihet mirë nga dialektologjia. Kjo është e domosdoshme sidomos në rastet kur materialet e folklorit shërbejnë si mbështetje për punimet gjuhësore, mbasi edhe në regjistrimin më të përpiktë folklori, veçanërisht gjuha e këngës, nuk është mirë të merret si bazë për konkluzione gjuhësore (sidomos fonetike) pa pasur edhe njohje të mirë për gjuhën e folur, përndryshe biem në gabime e arrijmë në përfundime të pasakta. Në punime të ndryshme gjuhësore (punime dialektore e gramatika) është cituar shpesh folklori, por ai është vështruar si të kishte qenë thjesht pasqyruar i së folmes. Duke marrë shkas nga kjo, në këtë artikull po japim disa veçori të gjuhës së këngëve popullore të Malësisë së Madhe, të para në raport me gjuhën e folur, me qëllim që nga ky raport të dallohen e të dalin më në pah disa nga dukuritë interesante të këtyre të folmeve, të cilat duke qenë tipare konservative<sup>2</sup>, kanë tërhequr e tërheqin, me të drejtë, vëmendjen e historianëve të gjuhës sonë. Veç kësaj artikulli, duke bërë objekt kërkimi dallimet midis gjuhës së këngës dhe gjuhës së folur, tregon se dialektologjia shqiptare, pas eksplorimit informativ pothuaj të plotë të mbarë truallit të shqipes, ka përpara detyra të reja për studimin më të thelluar të të folmeve, duke u ndalur edhe në dallimet stilistikore që hasen brenda tyre, gjë që jep mundësi të depërtohet më thellë në veçantitë dhe të përbashkëtat e grupeve të të folmeve ose të mbarë dialektit.

Me këtë artikull të parë ne vetëm sa do ta prekim problemin duke

1) W. Fiedler, *Disa çështje të metrikës së këngëve popullore çame*, në «Gjurmime albanologjike», 2, 1965, f. 319-322.

2) Kemi parasysh sidomos togjet, *uo*, *ua*, tipar interesant i këtyre të folmeve, i cili na paraqet një zhvillim paralel me toskërishten (*uo* > *ua*), veçse në një periudhë më të vonët e në një fazë edhe sot të papërfunduar plotësisht.

sjellë disa shembuj nga të folmet e Malësisë së Madhe, pra është vetëm një pikënisje, një sinjalizim.

Disa fakte do të parashtrihen vetëm si konstatime pa hyrë në argumentimin e tyre, për arësye se një gjë e tillë është e pamundur të bëhet me sukses pa bërë vëzhgime edhe në vise të tjera të Shqipërisë Veriore si Dukagjini, qyteti i Shkodrës etj., punë të cilën shpresojmë ta mbarojmë në të ardhmen.

\*

Në ekspeditat tona në Malësinë e Madhe kemi pasur rastin të regjistronim nga të njëjtët njerëz edhe biseda edhe këngë (të kënduara e të recituara), gjë që na ka dhënë mundësi të nxjerrim disa dallime të rëndësishme në mes të gjuhës së këngës dhe gjuhës së folur.

Gjëja e parë që i dallon këngët nga të folurit është stili i tyre poetik. Ato si gjuhë e poezisë gojore karakterizohen nga zgjedhja e fjalëve, nga vendosja e tyre në përshtatje me kërkesat e ritmit, të rimës, të plotësimit të vargut etj. Nga ana tjetër, ndërsa në gjuhën e folur ka më shumë dallime nga një e folme në tjetrën (megjithëse të folmet e Malësisë janë shumë të afërta), në këngët vërehet një gjuhë disi më e njësuar, me më shumë trajta të përbashkëta. Pra, po të shprehemi me fjalët e A. Desnickajas, në gjuhën e këngëve kemi një koine poetiko-gojore për mbarë Veriun. Megjithatë mendimi i Desnickajas se «*Koineja poetiko-gojore e Shqipërisë veriore në tiparet e saj themelore i përgjigjet gjendjes së gegërishtes së vjetër, nga e cila në këtë ose atë shkallë janë larguar të folmet e gegërishtes së sotme*»<sup>3</sup> është për t'u parë. Duke shprehur një deduksion të tillë autorja sikur pranon vetëm kalimin e këngëve nga brezat e vjetër tek të rinjtë dhe nuk përmend kalimin e këngës nga një krahinë në tjetrën, i cili, është gjithashtu me rëndësi. Hartues këngësh ka më pak se sa këngëtarë, prandaj kënga përhapet e ruhet pikërisht ashtu si mësohet dhe trajta që i ka dhënë asaj hartuesi i parë mbetet gjithnjë, duke pësuar vetëm ndryshime të vogla. Pra, në gjuhën e këngëve, ruajtja e tipareve arkaike vëndëse, gërshetohet e ngjizet fort me mbartjen e dukurive nga një krahinë në tjetrën, gjë që e vështirëson mjaft zgjidhjen e problemit. Dallimi i gjuhës së këngëve nga gjuha e folur është pra prodhim i një tradite të farkëtuar nga një sërë faktorësh, në mes të cilëve më të rëndësishmit janë: 1) ngjyrimi dhe plotësimi i rrokjeve (veçori thjesht muzikore), 2) interpretimi i këngëve me zë shumë të lartë, 3) nevojat e ritmit e të rimës, 4) kalimi i këngëve nga njëri brez tek tjetri dhe nga një krahinë tek tjetra pa u ndryshuar shumë as në trajtat e fjalëve as në leksik.

Faktori i parë dhe i dyti sjellin sidomos dallime fonetike. (I dyti, interpretimi me zë shumë të lartë, ka të bëjë më tepër me këngët «majekrahit»). Faktori i tretë (rima dhe ritmi) sjell dallime morfologjike e morfologjike-sintaktike, ndërsa faktori i katërt sjell kryesisht dallime leksikore e morfologjike.

Një rëndësi të madhe ka gjithashtu lloji i këngës, melodia e saj. Në Malësi të Madhe këndohen tri lloje këngësh:

- a) këngë «majekrahit» a «përmekrahit»
- b) këngë me lahutë «kâtëk laudet» a «kân laudet»
- c) këngë në grup «valle» a «bylbyli»

3) A. Desnickaja, *Albanski jazyk i jego dialekti*, Leningrad 1968, f. 79.

Këngët «majekrahit» këndohen të pashoqëruara me ndonjë instrument, prandaj fjalët e M. Lambercit «këngët që këndohen me lahutë quhen edhe «këngë në majë të krahit», sepse në atë mes e vënë dorën me gishta të shtrirë në vesh, gishtin e vogël te veshi e gishtin e madh të dorës së djathtë duke e mbështetur në lartësi të supit... që të kumbojë kënga në vesh e të dhiet mirë...»<sup>4</sup> nuk puqen me ndarjen reale të këngëve të kësaj krahine. Këngët që shoqërohen me vegël muzikore, me lahutë, quhen vetëm «kâtk laudet» a «kâη laudet» dhe dallojnë preraz nga këngët «majekrahit» dhe nga këngët në grup, «vallet», para së gjithash sepse të fundit interpretohen pa asnjë lloj instrumenti.

Këngët «majekrahit» këndohen vetëm nga burrat, solo ose dy vetë së bashku. Karakterizohen nga ngritja e zërit në shkallën më të lartë të mundshme. I mbështetur në këtë veçori të tyre, E. Çabej, duke i konsideruar si meloditë «që do të jenë muzikalisht dhe kronologjikisht më të vjetra»<sup>5</sup>, ka shprehur mendimin se për nga gjeneza «këto melodi nuk janë tjetër veçse thirrma e britur dhe e dëgjueshme që larg të cilën e ndeshim në të gjithë popujt malësorë». Edhe pleqtë e atyre anëve flasin për një origjinë të tillë. «*Me kâtk jân marr vesh/ m'at kôn // prej n'i mal e n'tietrin, kan kumtua luftnat //*» (Kështu na tha tetëdhjetëvjeçari Gjon Nik Luni nga Bajza). Kënga «majekrahit» përbëhet nga një kumtim tri vargjesh. Vargu i dytë dhe i tretë përsëriten, kështu që kënga ka gjithsej pesë «fjalë» (= varje).

Këngëtari vë të dy duart në faqe duke zënë vrimën e veshit me gishtin tregonjës (kur këndon solo), ose vetëm njërën dorë (kur këndon së bashku me një tjetër). Zëri i tij vjen e rritet që nga fjala e parë e vargut dhe arrin kulmin në fjalën e fundit. Mbas çdo vargu bëhet një pushim, për t'u mbushur me frymë mirë e mirë, mbasi gjatë këngës nuk duhet të ketë asnjë ndërprerje ose ulje të papritur të zërit. Mjeshteria e këngëtarit, në këtë lloj kënge, duket pikërisht në aftësinë e zgjatjes së zërit pa zbritur shkallën e lartësisë dhe pa bjerrë timbrin.

Melodia e këngës «majekrahit» si dhe «fjalët» (= varjet, përmbajtja) janë të njëjta për mbarë Malësinë e Madhe<sup>6</sup>. Edhe dallimet në mes të gjuhës së këngës «majekrahit» dhe gjuhës së bisedës janë të njëjta me mbarë Malësinë, megjithatë theksojmë se mbështetemi kryesisht në vëzhgimet e bëra në Kastrat, Shkrel, Hot, Koplik e Rrjoll, kështu që në vise të tjera të kësaj treve që s'janë eksploruar, mund të ketë edhe ndonjë veçori tjetër përpos këtyre që po japim më poshtë.

1. Në të folmet e Malësisë së Madhe [Grudë, Hot, Kastrat, Kelmend, Shkrel], të Rranxave të Mbishkodrës [Grizhë, Koplik, Lohe, Reç, Rrjoll] si dhe në disa pika të populluara nga banorë të shpërngulur nga Malësia e Madhe [Bregu i Matës, Ishulli i Lezhës e i Shëngjinit, Balldreni etj, në rrethin e Lezhës] hasen togjet *uo*, *ua*, të cilët i përgjigjen *ua*-së së toskërishtes, ose *ue* > *u*-së së të folmeve të tjera të gegërishtes. Është

4) M. Lambertz, *Die Volksepik der Albaner, Epika popullore e shqiptarëve*, 1958, f. 129.

5) E. Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, Shkodër 1938, f. 54.

6) Fjalët e melodisë «majekrahit», janë gjithësej këto:

*Fjalë bjen era, luftë po bânë, Rogova e Peja;*

*Fjalë për tel, thuoj Gjakovës, çôu e del;*

*Fjalë ka çua, thuoj Gjakovës, ke gabua*

*Burrë i vogël, i hipka atit, bjen në Shkodër,*

*Fjalë ka ardh, mblidhnju krenë, e bajroktar,*

*Djal i ri, i bjen pazarit, pa mahi.*

kjo, pra, një pikë konservacioni i këtyre të folmeve që i dallon preraz nga të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes, duke paraqitur kështu një zhvillim paralel me toskërishten, por në një fazë më të vonët. Simbas materialeve që kemi, në të gjitha pikat e përmendura më sipër thonë: *grua, ftua, prua, krua, me punua, me shkua, me u gzua, me luftua, me knua* etj. Me një fjalë (duke lënë mënjanë disa lëkundje e dallime ndërmjet brezash) mund të thuhet që në fund fjale ka gjithmonë *ua*, ndërsa në pozita të tjera, në mes fjale, ruhet *uo* — si një shkallë më e vjetër nga e cila ka dalë *ua*-ja: *gruos, duol, muor, buoll, shuoll, mzuor* etj.

Në rrokje të hapur *uo*-ja haset shumë rrallë dhe vetëm në brezin e vjetër. Këto togje, ndërsa në të folur ruhen të plota, gjatë këngës «majekrahit» ato kumbojnë thjesht *o*:

në këngë:

O po jo fjale ka ço  
O jo po *thoje* Gjokoves  
O po jo ke *gabo*

në bisedë:

Fjāl ka çua  
Thuoj Gjakovs  
ke *gabua*

2. Zanoret *i, y, u, ë* nuk hasen asnjëherë në këngët majekrahit. Kjo lidhet me nevojën e një ngritjeje sa më të lartë të zërit, për të cilën, më të përshtatshme janë zanoret *o* dhe *e*, prandaj ndodh ngjyrimi i tyre:

*i* në *e*:

o po jo djale j re (= o po jo djal i ri)  
*u* në *o*:  
O jo po *borre* j voo (= o jo po būrr i vogël)  
O po jo *lofte* po boojn (= o po jo lūft po bājn)

*á* — hundore kumbon si *o*, shumë pak e nazalizuar:

o jo po *lofte* po *boojn* (= o jo po luft po bājn)

Ë-ja e patheksuar, edhe në ato pozita ku në bisedë nuk ndihet fare, në këngë dëgjohet qartë dhe kumbon si *e*:

O po jo fjale për tel (= o po jo fjāl për tel)  
O po jo *lofte* po boojn (= o po jo lūft po bājn)  
O jo po *djale* j re (= o jo po djāl i ri)

Këngët e grupit të dytë interpretohen me lahutë. Këngëtari i bie lahutës dhe këndon duke u përpjekur që zëri i tij të shkrihet sa më fort me tingujt e lahutës, prandaj në fund të çdo vargu ka një zgjatje të zërit mjaft të madhe.

Këngët e grupit të tretë, «vallet», janë të shumta dhe të shumëllojshme. Intepretohen në grupe, ose edhe solo me alternim: njëri grup ose solist prin, ndërsa tjetri përsërit të njëjtin varg ose përparon në vargun që vjen pas. Dallimet nga gjuha e bisedës për këto dy grupe janë përgjithësisht të njëjta, prandaj po i përmbledhim së bashku duke bërë, aty-këtu, edhe diferencimin e tyre.

### Dallime fonetike

1. Togjet *uo* dhe *ua*, në të dy grupet pësojnë më pak ndryshime se në këngët «majekrahit». Në këngët me lahutë togjet ruhen, por ka edhe raste që *ua*-ja kumbon si *ue*. Kjo ngjet më tepër kur fjalët që mbarojnë

me togun zanor *ua* gjenden në fund të vargut, ku, siç e theksuam më sipër, për të shkrirë zërin me tingujt e lahutës, këngëtari e zgjat zërin në fund të çdo vargu duke shtuar një *e* mbas togut *ua*. Kështu duke u shkrirë *ua-* me këtë *e* të shtuar, nganjëherë duket sikur ka *ue* dhe jo *ua*. Kështu p.sh. në këngën «Mujo dhe Halili» që ka regjistruar Lamberci<sup>7</sup> në fshatin Lofkë të Grudës, mbizotëron togu *ue* [nga 73 fjalë me tog-zanor 69 dalin me *ue* dhe vetëm 4 me *ua*]. A. Desnickaja për këtë thotë se shqiptimi i diftongut *ue* ka mundësi «të jetë rrjedhim i traditës letrare-gojore gjuhësore që lidhet me interpretimin e këngës...»<sup>8</sup>, kurse për shembujt me *ua* thotë se kanë hyrë nga gjuha e gjallë.

Ne nuk e mohojmë rolin e traditës së intepretimt të këngës, të cilin e vë në dukje Desnickaja, por nga vëzhgimi i gjatë dhe në kushte të përshtatshme, neve na rezulton se kalimi i *ua-së* ose *uo-së* në *ue* është një çështje më tepër muzikore sesa fonetike gjuhësore, më tepër e çastit sesa prodhim i traditës.

Lidhur me këtë pikë (me togjet e zanoreve) duhet të vëmë re se regjistrimi i këngëve, i vajtimeve dhe i krijimeve të tjera gojore që janë mbledhur e botuar para çlirimit, nuk na duket të jetë bërë me saktësi. Në shumicën dërmuese të materialeve nga Malësia ka *ue* në çdo pozicion, gjë që, duke u nisur nga gjëndja e ruajtur e këtyre të folmeve, na bën të themi se nuk i përgjigjet realitetit fonetik të kohës. Besojmë se (kemi parasysh edhe pika të tjera sidomos në ndërtim të frazave) mbledhësit do të kenë vënë dorë mbi materialin, duke u përpjekur ta rrafshonin me fonetikën e të folmes së qytetit të Shkodrës<sup>9</sup>.

Nganjëherë, sidomos në këngët e grupit të tretë, togu *uo* kalon në diftongoid *u<sup>0</sup>*:

Oj çika çikes o po m'ja *lu<sup>0</sup>jka* synin;

ose:

Me sy t'zes e me m'lotua

Oho me ken dekun nuk e lâ pau *çu<sup>o</sup>mun-o*

«mori e mira syt' e zes», kënduar nga Gjergj Keqi, Bajzë.

2. Në gjuhën e folur, në mbarë të folmet e Malësisë, *e-ja* e gjatë dhe e mesme zbërthehet në *ie*: *Gjieta* «Gjeto», *qief* «qef», *gjieta* «gjeta», *gjeli* «gjeli», *qiepa* «qepa», *ku kie* «ku qe», *jie* «je» etj. Në gjuhën e këngës, zbërthimi është më i rrallë.

A m'je njeri a po m'je zân?

«Ti syzëz ç'i po mljeth sân»,

kënduar nga Gj. Keqi e G. Ni-

kolla (Bajzë)

Në bisedë këngëtarët e shqiptojnë këtë varg kështu: «*a m'je njeri a po m'je zân?*»

3. *Ë-ja* e patheksuar, tek fjalëzat proklitike, ndërsa në gjuhën e folur nuk ndihet fare, në këngë dëgjohej qartë dhe kalon në *e*: (shih edhe më lart për këngët e grupit të parë)

A ma ke ti jaranin *te* keq?

A ma ke jaranin *ne* vllazni?

7) M. Lambertz, *Albanische Märchen* (und andere Texte zur albanischen Volkskunde), Wien 1922, f. 176.

8) A. Desnickaja, *Vep. e cit.*, f. 82.

9) Kemi parasysh botimet folkloristike të bëra në «Visaret e kombit», I, II, III.

«Gjuri Harambash», këngë lahute, kënduar nga Mark Frani, Bajzë.  
 Dielt e ri te kan trathtua  
 Tuo j ra fellit tuo kenua  
 «Mori e mirë ç'i more bjeshkën», kënduar nga një grup fshatarësh nga Bajza.  
 Raft ni shi e te zbeloft  
 Raft ni bor e te meloft  
 «Fryni era lu<sup>o</sup>ji rana», kënduar nga një grup djemsh e vajzash në katundin Stol të Shkrelit.

4. Për të zhdukur hiatin që krijohet në mes të një zanoreje fundore dhe një nistoreje, shpeshherë, në këngët e këtyre dy grupeve shtohet një j:

Mori e mira but' e bardh  
 Tash tri jav nuse m'ke jardh  
 «Mori e mira but' e bardhë», kënduar nga një grup vajzash nga Bajza.

Jât ma t'mirën s'e shoh kun  
 Syt' e zes ja rroksha jun  
 Kënduar nga M. Preka (Shkrel), G. Nikolla (Bajzë) dhe me një grup grash e burrash të tjerë.

Nganjëherë shtimi i j-së nuk ka të bëjë me hiatin, por është një shtesë që bëhet për arësye muzikore.

Po vin barkat me bojâma (= bajame)  
 Me bojama Venedikut  
 Me ja plas zemrën jashikut  
 «Fryni era lu<sup>o</sup>ji rana», kënduar nga një grup burrash e grash nga Bajza.

5. Në këngët përdoren disa trajta të vjetra të asimiluara, të cilat në gjuhën e folur as në brezin e vjetër as në të riun nuk hasen: p.sh.

Morje e mira sylarushk  
 Ty ta gjosha qenin pūshk  
 Ty ta gjosha qen' e zi  
 . . . . .  
 Hike mren e shtruoke shtran  
 A t'bje r'men për muo te ngran  
 «Mori e mira sylarushk», kënduar nga M. Frani (Bajzë).

Në të folur dëgjohet gjithnjë: *qenin, shtratin, të ngratin*.

6. Në këngët, sidomos në ato të grupit të tretë, duket shumë qartë ndikimi nga të folmet e tjera, nga gjuha letrare dhe veçanërisht nga e folmja e qytetit të Shkodrës. Këngët e reja, sidomos ato që shoqërohen me fizarmonikë a me vegla të tjera moderne, këndohen me trajtat fonetike të qytetit të Shkodrës, nga janë marrë, p.sh.

Kur t'merzitem po e vi e rri  
 N'tesha tuja po vi e bi

Në të folur, edhe brezi i ri, në vend të fjalëve të nënvizuara përdor trajtat: *tuoja, bie*.

*Dallime morfologjike*

Edhe në fushën e morfologjisë, midis gjuhës së këngës dhe gjuhës së folur ka disa dallime.

1. Ndërrime gjinie për punë të rimës:

Mori e mira te Pojata  
Syt'zes e flokt' e g-jata

Në bisedë gjithnjë dëgjohet «flokt e g-jat», p.sh. i njëjti njeri që këndonte këtë këngë [M. Preka nga Shkreli] na tha në bisedë: «i kite *lshua flokt e g-jat*».

2. Në këngët, hasen trajta foljore, të cilat s'hasen asnjëherë në bisedë të lirë dhe që janë futur gjithashtu nga nevoja e rimës, p.sh.

a) Shum u gzova kur te pava  
T'tân çobât me ret i shava

(Në bisedë e kryera e thjeshtë e *shoh*, në të folmet e Malësisë, del gjithmonë me trajtën *pâsh* e jo *pava*.)

b) Çohej deti hova hova  
At ma t'mirën fort e doja

(*doja*, trajtë e së pakryerës, nuk na del asnjëherë në bisedë; në këto të folme gjithnjë kemi dëgjuar: *doshem, doshe, dosha*; në brezin e vjetër: *doshtesh* dhe *dontesh*<sup>10</sup>.)

3. Disa dallime morfologjike vijnë edhe nga fakti se këngët, duke u trashëguar brez pas brezi, në përbërjen e vet, ruajnë trajta të vjetra, tashmë të zhdukura nga përdorimi i gjallë në bisedë p.sh. pjesoret në *-më*: *bâmë, pamë* etj. të cilat sot në këto të folme dalin me trajtat: *bâ, pâ* etj., p.sh.

Hajt e sherr po ku m'ke *pâm*  
N'at ulic tuo nej ne *zâll*

«Mori e mira but' e bardhë», kënduar nga Z. Kola (Gruemirë)

Folja *ha*, në gjuhën e bisedës, në këto të folme, sot ka trajtat: *hangra* (kr. thj.), *hangër* (pj.), por në këngët ruhet edhe trajta e pjesores *ngrân*, p.sh.

Diçka deshta me të thân  
Për jât moll' ç'i t'kam pa dhân  
A e ke kalb a e ke grân?

S'e kam kalb jas s'e kam grân

Tre pash thellë e kam shti n'rân

«Fryni era lu<sup>0</sup>jt'i rana», kënduar nga një grup burrash e grash (Bajzë)

Kjo trajtë, *grân* «ngranë», së bashku me mbiemrin i *grânun* «i ngranun» (= i mbaruar, i dobësuar) që e kanë këto të falme, dëshmon se dikur, njësoj si në toskërishten e sotme, folja *ha* ka pasur pjesoren me trajtën *ngranë* (khs. *ngrënë*), por e humbi dhe mori trajtën *hangër*, në analogji me të kryerën e thjeshtë *hangra*.

10) Shih Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kastriotit*, «Studime filologjike», nr. 2, 1967 f. 63.

4. Në bisedë paskajorja e dytë *për + me + pjesore* haset shumë rrallë, ndërsa në këngët del rëndom e, kjo, simbas nesh, mund të jetë ose ruajtje e trajtës së vjetër që i ka pasur dikur mbarë veriu, ose mbartje nga krahinat prej nga mund të jetë mësuar kënga.

A po t'dhimet dazma *për me bâ*

A po t'dhimen paret *për me j la*

«Martesa e Halilit», kënduar nga M. Frani (Bajzë)

Qyr ç'ka bâni Muja *për me bâ*

Po t'bâj be û vlla me t'lumin zot

Kurrni mik un besa nuk po e kam

Kam dasht shoqet *për me i rrejt*.

«Gjuri Harambash», kënduar nga M. Frani (Bajzë)

Në podrum gjogun ja ka çua

Në ven't tagjis oris *për me ngrân*

«Zugu Bajraktar», kënduar nga M. Frani (Bajzë)

5. Rendi i fjalëve në këngët, duke qenë i varur nga ritmi e rima, është mjaft i ndryshëm nga ai i bisedës; kështu p.sh., ndërsa në të folur ndajfolja zakonisht vjen pas foljes, në këngët ndajfolja prin dhe folja vjen pas saj, p.sh.:

N'od te miqet Gjuri po i shtjen

U bân ner e u bân qeram

*Mir kan hâgër e mir kan pi*

«Gjuri Harambash», kënduar nga M. Frani (Bajzë)

### Dallime leksikore

Gjuha e këngëve, sidomos e epikës legjendare, si gjuhë poetike e krijimtarisë gojore është plot fjalë të bukura, plot epitete që karakterizojnë tiparet e kreshnikëve, fuqinë, trupin dhe mjedisin e të bëmeve të tyre. Nga ana tjetër, ato, në pjesën më të madhe të tyre, nuk janë krijime të reja, por trashëgim nga kohë mjaft të largëta, gjë që kushtëzon vjetërimin e shumë fjalëve që gjëndjen brenda tyre. Kështu p.sh. ato janë plot me fjalë si *zylyfet* «flokët», *sumullat* «pullat», *cubat*, *dyrek* «hekur për të mbërthyer derën», *ulic* «rrugë», *martinja* «pushka, arma» *bixhi* «mjeshtër, specialist për diçka», *fishektare* «pushka, arma» etj. Këto fjalë jo vetëm nuk përdoren në bisedë, por nganjëherë, brezi i ri e i mesëm s'i kupton fare e brezi i vjetër e ka mjaft të mjergullt kuptimin e tyre. Ka raste që këngëtari përdor në këngë fjalë si *qyleri*, *pojata* etj., por kuptimin e tyre nuk e di. Kësisoj, leksiku i këngëve merr një rëndësi të madhe për të njohur diferencimin llojor stilistikor të fjalorit të gjuhës.

Duke i mbyllur këto pak shënime, mund të themi se vështrimi i raportit të gjuhës së këngës me gjuhën e folur, paraqitet si një çështje me interes për dialektologjinë. Me një studim të thelluar të këtij problemi, duke e shtrirë vështrimin jo vetëm në një zonë të kufizuar, siç bëmë në në këtë artikull të parë, por në mbarë një grup të folmesh, mund të nxirren konkluzione të vlefshme për trajta të ndryshme gramatikore.

## R é s u m é

CERTAINES PARTICULARITES DE LA LANGUE  
DES CHANTS POPULAIRES

Dans l'article Certaines particularités de la langue des chants populaires, l'auteur soulève des questions qui sont en rapport entre le langage courant et la langue du chant populaire. Le but de l'auteur est que les matériaux du folklore, à connaissance de ce rapport, soient utilisables dûment par la linguistique.

L'auteur est de l'avis que la composition phonétique et morphologique de la langue du chant est souvent déterminée par la structure rythme-mélodie du chant, c'est pourquoi le chant, même dans l'enregistrement le plus exact, ne concorde pas avec le langage parlé.

S'appuyant sur les observations faites dans la région de la Malessie Madhe (arrondissement de Shkodër), l'auteur a tiré quelques distinctions importantes entre le langage parlé et la langue des chansons de cette région. Sur la base des distinctions qu'elles offrent du langage parlé, l'auteur divise les chansons en trois groupements: a) chants majekrahu, b) chants joués sur la lahute (sorte de luth), c) chants en groupe «dances». Dans le premier groupement il n'y a que des différences phonétiques, mais dans les deux autres groupements il y a des différences phonétiques et morphologiques, c'est pourquoi l'auteur a réuni ensemble leurs particularités.

Pour les différences phonétiques, l'auteur s'est arrêté davantage sur les groupes de mots *uo ua*, en faisant ressortir que ces groupes de voyelles sont gardés dans les chansons joués à la lahute, mais il y a aussi des cas où l'*ua* résonne comme un *ue*. Or bien, si l'auteur russe Desnitskaya rattache cela à la tradition de l'interprétation du chant, l'auteur appelle cette manifestation comme un phénomène plutôt musical que linguistique, plutôt une manifestations instantanée qu'un produit de la tradition.

A ce propos, l'auteur fait noter également que l'enregistrement des plaintes et des planctus, ainsi que des autres créations orales glanées antérieurement à la libération du pays, n'a pas été effectué exactement, du fait qu'il y a *ue* dans toute position, ce qui ne concorde pas avec l'état effectif de ces parlars, où à tout ce jour il y a *uo ua*.

Dans le domaine de la morphologie, aussi, l'auteur a apporté plusieurs exemples de différences: p. ex. dans les chants on a des formes morphologiques qu'on ne rencontre jamais dans un entretien libre. Ex.: *pava* pour *pâsh* (l'aoriste de *shoh* = «voir»), *doja* pour *doshem*, dont la source se situe dans les besoins de la rime.

D'autres différences morphologiques découlent aussi du fait que les chants, passés en patrimoine d'une génération à l'autre, gardent, dans leur composition, des formes anciennes, désormais tombées en désuétude. Ex.: les participes en *-me*: *pame*, *bame*, etc., qui dans le parler courant sont: *pa*, *bâ*, etc.

Au point de vue du lexique, aussi, la langue des chants mérite une attention particulière de la part du linguiste. Les chants, dont une bonne partie ne sont plus des créations nouvelles, mais des patrimoines venant de temps assez lointains, conditionnent également le vieillissement de beaucoup de mots, dont ils sont les porteurs. Et cela au point que, souvent, la nouvelle génération n'en connaît plus le sens.

